

Viti i ëndrrave të Kosovës: Çfarë mund të kishte qenë në vitin 2025

Autor: Besar GËRGI – Hulumtues, Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Vëmendje: Meqenëse është kaq e vështirë të gjesh pak pozitivitet në situatën aktuale politike, na u desh të shpiknim një realitet paralel për të bërë një krahasim të asaj që mund të kishim pasur nëse gjërat do të shkonin mirë. Ngjarjet e paraqitura në këtë artikull, për fat të keq, janë tërësisht fiktive.

Të dashur lexues,

Gëzuar Vitin e Ri 2026!

Viti që po lëmë pas ishte sigurisht i paharrueshëm me shumë ngjarje pozitive që ndihmuan në shtytjen përpara të aspiratave europiane të Kosovës.

Në fillim të vitit, partitë politike arritën shpejt të kuptonin se Kosova ka nevojë për një ekzekutiv të qëndrueshëm për të ndjekur qëllimet e saj strategjike, prandaj lanë pas dallimet e tyre ideologjike dhe politike dhe krijuan një qeveri të qëndrueshme dhe një Kuvend funksional.

Sapo u krijua qeveria, ajo menjëherë vazhdoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Huasë nga Plani i Rritjes dhe e paraqiti atë në Kuvend së bashku me Marrëveshjen e Facilitetit tashmë të nënshkruar. Deputetët, duke kuptuar detyrën e tyre për t'i shërbyer aspiratës europiane të popullit dhe jo grindjeve të përditshme, votuan në favor të marrëveshjeve pothuajse unanimisht. Pas disa hapave teknikë, brenda disa javësh, Kosovës iu nda parafinancimi prej rreth 61.8 milionë eurosh, nga të cilat rreth 55% u ndanë për Kornizën e Investimeve në Ballkanin Perëndimor dhe pjesa tjetër u dedikua si mbështetje e drejtpërdrejtë buxhetore për qeverinë. Pas pothuajse dy vitesh masash ndëshkuese, kjo ishte një shenjë shumë pozitive nga Bashkimi Evropian për Kosovën.

Politikanët përgjegjës të Kosovës e kuptuan se vetëm deklaratat verbale të përkushtimit ndaj Bashkimit Evropian nuk janë të mjaftueshme. Siç thotë shprehja e vjetër, fjalët janë të mira, veprat janë më të mira. Prandaj, qeveria e re nisi të zbatojë seriozisht dhe me shpejtësi të gjitha hapat e reformës të përcaktuara në Axhendën e Reformës së Kosovës. Si rezultat, deri në fund të këtij viti, Qeveria e Kosovës zbatoi me sukses të gjitha 40 hapat e reformës të përcaktuara për tre semestrat e parë dhe si rezultat iu ndanë gjithsej 300 milionë euro duke përlogaritur edhe parafinancimin. Një sasi kaq masive investimi nxiti një rritje ekonomike mbresëlënëse për Kosovën.

Një performancë kaq shembullore nga Kosova u bë një faktor kryesor në vendimin e Këshillit dhe Komisionit Evropian për të tërhequr masat ndëshkuese të vendosura në qershor 2023. Në fund të fundit, ishte shumë e padrejtë të mbaheshin masa të tilla kundër një vendi që kishte një historik kaq të shkëlqyer në zbatimin e reformave të orientuara drejt BE-së. Edhe kundërshtarët më të zjarrtë të

tërheqjes së masave ndëshkuese humbën argumentet e tyre nga një performancë e tillë. Në fakt, ekziston një momentum për të hapur negociatat e anëtarësimit me Kosovën, por diskutimet janë ende në vazhdim.

Ekspertët besojnë se duke zbatuar Agjendën e Reformave në një mënyrë kaq vendimtare, Kosova padyshim përfitoi financiarisht, por po ashtu përmirësoi edhe shanset e saj për t'u futur në BE. Raporti i Vendit i këtij viti ishte shumë pozitiv dhe pati përmirësime në vlerësimin e përgjithshëm në shumicën e fushave të politikave. Ekspertët deklarojnë se një përparim i tillë do ta ndihmojë Kosovën në të ardhmen të ketë negociata më të lehta për anëtarësim.

Siç mund ta shihni, Kosova pati një vit të jashtëzakonshëm falë një klase politike të përgjegjshme. Ata ishin në gjendje të shkonin përtej sloganeve dhe të linin mënjanë dallimet e tyre për të punuar për të mirën e përbashkët. A thua si do të shkonin gjërat nëse në vend të kësaj, do të ngujoheshin në pozitrat e tyre dhe do të humbisnin një vit të tërë në debate të pafrytshme?